



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

---

Numri i lëndës: 2019:238006  
Datë: 16.05.2024  
Numri i dokumentit: 05694637

KE.nr. 221/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen juridike të Paditësit “Banka për Biznes” me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson Debt Loan Recovery me përfaqësues E.S., kundër të paditurve 1. N.T.P “Getor – AG” me seli në Gjakovë, 2. Sh.K. nga Gjakova, të cilit i përfaqëson sipas autorizimit Avokat Avdi Rizvanolli me seli në Gjakovë dhe 3. I.Rr. nga Gjakova, me objekt kontesti kthimi i borxhit, vlera e kontestit 27,541.80 euro, duke vendosur sipas parashtresës së paditësit për tërheqjen e padisë, jashtë seance me datën 16.05.2024 merr këtë :

A K T V E N D I M

Konstatohet e tërhequr padia e paditësit “Banka për Biznes” me seli në Prishtinë, e ushtruar më datën 01.12.2003, kundër të paditurve 1. N.T.P “Getor – AG” me seli në Gjakovë, 2. Sh.K. nga Gjakova, dhe 3. I.Rr. nga Gjakova për kthimin e borxhit.

A r s y e t i m

Paditësi më datën 01.12.2003, pranë Gjykatës Komunale në Gjakovë ka ushtruar padi, ndaj të paditurve 1. N.T.P “Getor – AG” me seli në Gjakovë, 2. Sh.K. nga Gjakova, të cilit i përfaqëson sipas autorizimit Avokat Avdi Rizvanolli me seli në Gjakovë dhe 3. I.Rr. nga Gjakova për kthimin e borxhit në shumë prej 27,541.80 euro.

Gjykata Themelore Gjakovë me Aktvendim C.nr. 850/03 të datës 13.04.2004 është shpallur inkompetente lëndore për vendosje në këtë lëndë, ndërsa lënda është bartur në Gjykatën Komunale në Prishtinë si gjykatë e kompetencës lëndore.

Kjo lëndë është transferuar në Gjykatën Komerciale të Kosovës sipas vendimit me numër 347/22 të datës 28.07.2022 të KGJK-së për transferimin e lëndëve në Gjykatën Komerciale.

I autorizuari i paditësit përmes parashtresës së datës 15.05.2024, i është drejtuar kësaj gjykate, dhe ka kërkuar që të konsiderohet e tërhequr padia, pasi që me të paditurit kanë arritur marrëveshje jashtëgjyqësore për përmbushje të detyrimit, dhe parashtresës i ka bashkangjitur marrëveshjen e arritur.

Gjykata duke vepruar sipas parashtresës për tërheqje të padisë, konstatoj se e njëjtë po e tërheq padinë, andaj në kuptim të nenit 261 lidhur me nenin 387.1 pika c) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

#### GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr.221/22 me datë 16.05.2024

Gjyqtari  
Gent Bekeri

**KËSHILLA JURIDIKE :** Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.